



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË

QENDRA KOMBËTARE
E BIZNESIT
Nr. 3596 Prot.
Datë 04.02.2022



3H
ZYRA E PËRMBARIMIT
PRIVAT 3H

Nr. 877/8 Prot

Tiranë, më 01.02.2022

Nr 877Dosje

URDHËR

(PËR VENIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE)

Drejtuar : Qendra Kombëtare e Biznesit Tiranë,

Unë, Haxhi Ismaili, me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor, pranë Zyrës së Përmbarimit Privat "3H" SHPK, në referim të *Vendim Nr.2040, Date 06.04.2021 te leshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane*, kam vene ne ekzekutim keto *Vendim* duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr.877 kërkesën e *Kreditorit- Raffaella Banchetti*, qytetare italiane, lindur ne Rome, me 29.12.1964, banim ne Rome, perfaqesuar me prokure te posacme nga Av.Ervin Bano, per *Debitorin- Redi Peza* i dtl.17.03.1981 me nr personal I103170700.

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, duke i dërguar debitorit Lajmërimin për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban Urdheri i Ekzekutimit si dhe Njoftimin per deklarim, në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile,

KONSTATOVA Se :

Debitori- Redi Peza i dtl.17.03.1981 me nr personal I103170700 ka marrë njoftimin e Lajmërimin për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin si dhe Njoftimin per deklarim të detyrimit dhe nuk i eshte përgjigjur respektimit të afatit dhe kërkesave.

Në këto kushte në referim të nenit 527 të K.Pr.Civile duhet të filloj ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestër mbi kreditë e debitorit: Shoqeria "Kame Ndertim" shpk me Nipt L82412041Q dhe administrator Z.Ervis Kadriu në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit.

Përsa më sipër, në referim të neneve 36 pika (e), 37 pikat (b) dhe 53 (paragrafi i 1-rë) të Ligjit Nr. 26/2019 "Per Sherbimin Permbarimor Gjyqesor Privat",

Adresa :Bulevardi Zogu I, Sheshi Franc Nopça, Ndertesa 6, Hyrja 10, Apartamenti 23, Tirane Cel. 0692099711
Website: www.3-h.al

Email: shpgj_3h@yahoo.com

URDHËROJ

1. Qendra Kombëtare e Biznesit Tiranë, te verifikojë dhe të bëjë bllokimin e kuotave dhe të drejtat që rrjedhin nga zotërimi aksioneve të **Debitorit-Redi Peza i dtl.17.03.1981 me nr personal I103170700 ne shoqerite si me poshte:**

- IVR PROGETTI Shpk NIPT L21606017L me administrator Carlo Ranalletta
- JOLLA 2010 Shpk NIPT L09718301F me administrator Hergys Rreli
- Lalzi Marina Bay Development Shpk NIPT L62130014G me administrator Redi Peza
- M & P – I NIPT Shpk L32026015L me administrator Redi Peza
- S.I.S. - Albania - Societa Investimenti e servizi Shpk NIPT L41709007B me administrator Redi Peza
- Sviluppo Mare 1 Shpk NIPT L61706003C me administrator Redi Peza

2. Për informimin, bllokimin e shitjes së aksioneve dhe tjetërsimit të aktivitetit dhe veprimet që duhet të kryeni pas marrjes së njoftimit të këtij urdhri në lidhje me debitorin e sipërpërmendur të njoftohem në rrugë zyrtare brenda afatit administrativ nga ana Juaj.
3. Personat që bëhen pengesë, brenda afatit të përgjigjes zyrtare, që nga dita e njoftimit të këtij urdhri, do të përgjigjen sipas dispozitave sanksionuese që parashikon Kodi i Procedurës Civile dhe Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, në lidhje me pengimin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore apo të titujve ekzekutive, ku aplikohet sanksioni i gjobes në shumën 50.000 lekë në zbatim të nenit 606 të K.Pr.Civile si dhe kallëzim për pengim ekzekutimi në zbatim të nenit 320 të K.Penal.
4. Ky urdhër është i vlefshëm deri në një urdhër të dytë.
5. Ky urdhër mbahet në 4 (katër) kopje, dhe u njoftohet palëve të cilat kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 5 ditëve, nga dita e marrjes dijeni.

ZYRA E PËRMBARIMIT PRIVAT "3 H" SHPK PERMBARUES GJYQESOR

Haxhi ISMAILI



Adresa :Bulevardi Zogu I, Sheshi Franc Nopça, Ndertesa 6, Hyrja 10, Apartamenti 23, Tirane Cel. 0692099711
Website: www.3-h.al Email: shpgj_3h@yahoo.com